

VENDIM
Nr. 830, datë 24.12.2021

**PËR MASAT LIDHUR ME SIGURIMIN E INFORMACIONIT PËR KONSUMIN
E LËNDËS DJEGËSE DHE SHKARKIMET E CO₂ GJATË MARKETINGUT TË
AUTOMJETEVE TË REJA¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”, dhe të shkronjës “c”, të nenit 14, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e masave për sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ nga autoveturat e reja, të cilat ofrohen për shitje ose për dhënie me qira në Republikën e Shqipërisë. Ky informacion u vihet në dispozicion konsumatorëve, me qëllim:

- a) që t’u mundësojë atyre të bëjnë një zgjedhje të bazuar në informacion;
- b) promovimin e blerjes ose të dhënies me qira të autoveturave, që përdorin më pak lëndë djegëse dhe, në këtë mënyrë, shkarkojnë më pak CO₂ në mjedis.

2. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Autoveturë për pasagjerë”**, i njëjti kuptim sipas përcaktimit në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 54, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) **“Autoveturat e reja për pasagjerë”**, çdo autoveturë, e cila nuk i është shitur më parë, përveçse për qëllim shitjeje në pakicë apo shpërndarjeje për shitje;

c) **“Certifikata e përputhshmërisë”**, certifikata e përputhshmërisë të lëshuar nga prodhuesi;

ç) **“Etiketa për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂/Fuel economy label”** (në vijim “etiketa”), etiketa, që përmban informacionin për konsumatorin për konsumin zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike zyrtare të CO₂, për autoveturën ku është bashkëngjitur etiketa;

d) **“Konsum zyrtar i lëndës djegëse”**, konsumi i lëndës djegëse, siç përcaktohet në udhërrëfyesin për konsumin e lëndës djegëse të autoveturave të reja për pasagjerë, në certifikatën e përputhshmërisë të lëshuar nga prodhuesi ose në certifikatën e miratimit të tipit të autoveturës. Kur disa variante dhe/ose versione grupohen nën një model, vlera që duhet dhënë për konsumin e lëndës djegëse të atij modeli bazohet në variantin dhe/ose versionin me konsumin më të lartë zyrtar të lëndës djegëse brenda atij grupi;

dh) **“Literaturë promovuese”**, i gjithë materiali i shtypur që përdoret në marketing për reklamimin e promovimin e autoveturave për publikun e gjerë. Këtu përfshihen, të paktën, udhërrëfyes teknikë, broshura, reklama në gazeta, revista dhe shtypi i specializuar dhe postera;

e) **“Udhërrëfyes për konsumin e lëndës djegëse”**, përmbledhja e të dhënave zyrtare të konsumit të lëndës djegëse dhe të shkarkimeve zyrtare specifike të CO₂, për secilin model të autoveturave të reja, që është i disponueshëm në tregun vendës, sipas certifikatës së përputhshmërisë të lëshuar nga prodhuesi ose certifikatës për miratimin e tipit të autoveturës;

ë) **“Marka”**, emri tregtar i prodhuesit që paraqitet në certifikatën e përputhshmërisë dhe në dokumentacionin e miratimit të tipit;

f) **“Media e ruajtjes elektronike, magnetike ose optike”**, çdo material fizik, për të cilin informacioni mund të regjistrohet në mënyrë elektronike dhe që mund të shërbejë si mjet informacioni për publikun e gjerë;

¹ Ky projektvendim transponon pjesërisht direktivën 1999/94/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 13 dhjetorit 1999, në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, në lidhje me tregtimin e automjeteve të reja të pasagjerëve, të ndryshuar.

g) **“Model”**, përshkrimi tregtar i markës, tipit dhe, nëse është i disponueshëm e i përshtatshëm, varianti dhe versioni i një autoveture pasagjerësh;

gj) **“Pikë shitjeje”**, vendndodhja, që mund të jetë një sallë ekspozite/*showroom* autoveturash ose ambient i hapur, ku autoveturat e reja të pasagjerëve shfaqen, ofrohen për shitje, me qira për klientët e mundshëm apo edhe panairët tregtare, ku autoveturat e reja të pasagjerëve paraqiten për publikun;

h) **“Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂”**, për një autoveturë të caktuar pasagjerësh, informacioni, që jepet në udhërrëfyesin për konsumin e lëndës djegëse të autoveturave të reja për pasagjerë apo në certifikatën e përputhshmërisë së lëshuar nga prodhuesi ose në certifikatën e miratimit të tipit të autoveturës. Kur disa variante dhe/ose versione janë grupuar nën një model, vlerat që do të jepen për CO₂ të atij modeli do të bazohen në variantin dhe/ose versionin me shkarkimet më të larta zyrtare të CO₂ brenda atij grupi;

i) **“Shitës i autoveturave të reja të pasagjerëve”** (në vijim “shitësi”), personi që shet ose jep me qira autoveturat e reja të pasagjerëve të përdoruesi përfundimtar;

j) **“Shpërndarje me mjete elektronike”**, dërgimi i informacionit dhe marrja në destinacionin e tij me anë të pajisjeve elektronike për përpunim (përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtjen e të dhënave dhe transmetimin e plotë, të transmetuara e të marra me tel, me radio, me anë të mënyrave optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike;

k) **“Tip”**, **“variant”** dhe **“version”**, autoveturat e diferencuara të një marke të caktuar, që deklarohen nga prodhuesi, sipas përcaktimit në certifikatën e përputhshmërisë, të lëshuar nga prodhuesi e të identifikuar në mënyrë unike, sipas tipit, variantit e karaktereve të versionit alfanumerik;

l) **“Tregtar i autoveturave të reja të pasagjerëve”** (në vijim “tregtari”), prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, i vendosur në Republikën e Shqipërisë ose person tjetër fizik ose juridik, që importon dhe/ose vendos në treg autoveturat e pasagjerëve në Republikën e Shqipërisë.

3. Çdo tregtar/shitës, që shet ose jep me qira autovetura të reja për pasagjerë, është i detyruar të marrë masat për informimin e konsumatorëve lidhur me:

a) konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, për modelet e autoveturave që janë në shitje;

b) përmbajtjen e udhërrëfyesit, i cili përgatitet në përputhje me pikën 7 të këtij vendimi.

4. Tregtari siguron që:

a) të dhënat sipas pikës 3 t’u prezantohen konsumatorëve në mënyrë të qartë e të dukshme në çdo vend, ku autoveturat e reja janë të ekspozuara për qëllime promovuese. Të dhënat të jenë të vërteta, të sakta dhe të qarta, sipas informacionit të pasqyruar në etiketën, udhërrëfyesin, posterat, literaturën dhe materialet promovuese, reklama, që shoqërojnë autoveturën e re;

b) të dhënat e prezantuara të mos kenë shenja, simbole ose mbishkrime, në lidhje me konsumin e lëndës djegëse ose shkarkimet e CO₂, që nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, si dhe të mos shkaktojnë konfuzion për konsumatorin e mundshëm të autoveturave të reja;

c) dokumentacioni promovues për shitjen e autoveturave të reja të orientojë konsumatorët në vendimarrjen e tyre të blerjes në pikën e shitjes, për modelin e autoveturave të reja, i cili gjendet në atë pikë shitjeje e që përdor më pak lëndë djegëse dhe, për pasojë, shkarkon më pak CO₂ në mjedis.

5. Dokumentacioni promovues për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, për çdo model të ri autoveture në shitje, përfshin:

a) etiketën për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂;

b) udhërrëfyesin për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂;

c) afishimin/posterin për shitjen e autoveturave të reja;

d) literatura promovuese.

6. Etiketa të jetë në gjuhën shqipe e në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Etiketa vendoset ose shfaqet në mënyrë të qartë e të dukshme, pranë çdo modeli të ri autoveture në pikën e shitjes.

7. Udhërrëfyesi për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ përgatitet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), në konsultim me tregtarin në çdo vit, në përputhje me kërkesat e shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Udhërrëfyesi të jetë në version *hard copy*, si edhe në versionin elektronik. Versioni *hard copy* i shtypur në letër të jetë i transportueshëm, i mbledhur dhe falas për konsumatorët.

8. Afishimi/posteri për shitjen e autoveturave përmban të dhënat zyrtare lidhur me konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ për të gjitha modelet e reja të autoveturave të reja, që prezantohen ose ofrohen për shitje apo qira në ose nëpërmjet asaj pike shitjeje. Të dhënat shfaqen në një pozicion të dukshëm dhe në përputhje me formatin e kërkesave të shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Tregtari siguron që literaturat promovuese për secilin model të autoveturave të reja, të cilat ofrohen për shitje, përmbajnë të dhëna për konsumin zyrtar të lëndës djegëse e për shkarkimet specifike zyrtare të CO₂, në përputhje me kërkesat e shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Tregtari siguron që literatura promovuese të ndryshme nga ato në pikën 9, të këtij vendimi, për secilin model të autoveturave të reja që ofrohen për shitje, të përmbajë të dhëna për konsumin zyrtar të lëndës djegëse dhe për shkarkimet specifike zyrtare të CO₂.

11. Shitësi siguron që:

a) të marrë etiketën e çdo modeli të ri autoveture nga tregtari, në përputhje me pikën 6, të këtij vendimi;

b) të vërë në dispozicion etiketën falas për konsumatorët në pikën e shitjes;

c) të disponojë të paktën 50 (pesëdhjetë) kopje të literaturave promovuese dhe 50 copë udhërrëfyesish nga tregtari;

ç) të vërë në dispozicion botimin e fundit të udhërrëfyesit falas për konsumatorët në pikën e shitjes;

d) udhërrëfyesi për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ për modelet e autoveturave të reja vihet në dispozicion të konsumatorëve jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e botimit të tij.

12. Autoritetet përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e kërkesave të këtij vendimi janë:

a) struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë dhe mbrojtjen e konsumatorit;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) pranë ministrisë përgjegjëse për fushën e transportit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1.1.2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA I ETIKETA PËR KONSUMIN E LËNDËS DJEGËSE DHE SHKARKIMET E CO₂

Të paktën, të gjitha etiketat e konsumit të lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ në territorin e Republikës së Shqipërisë:

1. I përmbahen një formati të standardizuar, në mënyrë që të njihen më mirë nga konsumatorët/ të interesuarit;

2. Janë në një madhësi prej 297 mm × 210 mm (A4);

3. Përmbajnë një referencë të modelit dhe të llojit të lëndës djegëse të autoveturave, të cilës i janë bashkëngjitur;

4. Përmbajnë vlerën numerike të konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimeve zyrtare specifike të CO₂. Vlera e konsumit zyrtar të lëndës djegëse shprehet në litra për 100 kilometra (l/100 km), ose një kombinim i përshtatshëm i tyre dhe shprehet deri me një numër pas presjes

dhjetore. Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂ jepen në gram për kilometër (g/km), të rrumbullakosura në numrin e plotë më të përafërt;

5. Përmbajnë tekstin vijues, në lidhje me disponueshmërinë e udhërrëfyesit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂: “Një udhërrëfyes mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, i cili përmban të dhëna për të gjitha modelet e reja të autoveturave, është i disponueshëm falas në çdo pikë shitje”;

6. Përmban tekstin si vijon: “Përveç eficiencës së lëndës djegëse të një autoveture, mënyra e drejtimit të autoveturës, si dhe faktorët e tjerë joteknikë, luajnë rol në përcaktimin e konsumit të lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ të një autoveture. CO₂ është gazi kryesor me efekt serrë, përgjegjës për ngrohjen globale”;

7. Etiketa rekomandohet të përmbajë dhe një model të koduar me ngjyra, të ngjashëm me atë të etiketës së energjisë, me shkronja A-G, bazuar në shkarkime të ulëta dhe të larta;

Një prezantim grafik i etiketës mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, jepet më poshtë:

Prodhuesi:
Marka:
Tipi, varianti, versioni:
Lloji i lëndës djegëse:
Konsumi i lëndës djegëse: XX, X l/100 km ose XX, X m³/100 km
Urban/qytetës:
Extra-urban/interurban/ndërqytetës:
Përbërja:
Shkarkimet e CO₂: XXX g/km
Një udhërrëfyes mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO ₂ , i cili përmban të dhëna për të gjitha modelet e reja të autoveturave, është i disponueshëm falas në çdo pikë shitje. Përveç eficiencës së lëndës djegëse të një autoveture, mënyra e drejtimit të autoveturës, si dhe faktorët e tjerë joteknikë, luajnë rol në përcaktimin e konsumit të lëndës djegëse të një autoveture dhe në shkarkimet e CO ₂ , që është gazi kryesor me efekt serrë, përgjegjës për ngrohjen globale.

SHTOJCA II

UDHËRRËFYESI MBI KONSUMIN E LËNDËS DJEGËSE DHE SHKARKIMET E CO₂

Udhërrëfyesi mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

1. Një listë për të gjitha modelet e reja të autoveturave, të disponueshme për blerje në Shqipëri mbi baza vjetore, të grupuara sipas markave në rend alfabetik. Nëse udhërrëfyesi përditësohet më shumë se një herë në vit, të përmbajë një listë për të gjitha modelet e reja të autoveturave, të disponueshme në datën e botimit të këtij përditësimi;

2. Për çdo model që shfaqet në udhërrëfyes, jepet informacion mbi llojin e lëndës djegëse, vlerën numerike të konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike zyrtare të CO₂. Vlera e konsumit zyrtar të lëndës djegëse shprehet, në litra për 100 kilometra (l/100 km), në kilometra për litër (km/l), ose një kombinim i përshtatshëm midis tyre dhe pasqyrohet deri në një numër pas presjes dhjetore. Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂ shprehen të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt në gram për kilometër (g/km);

3. Një listë për 10 modelet e autoveturave, me eficiencën më të lartë të lëndës djegëse, të renditura në rend rritës për shkarkimet specifike të CO₂ për secilin lloj të lëndës djegëse. Lista të

përmbajë modelin, vlerën numerike të konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike zyrtare të CO₂;

4. Këshilla për drejtuesit e autovecurave, se përdorimi i saktë dhe mirëmbajtja e rregullt e autovecurave, si dhe mënyra e drejtimit, të tilla si: shmangia e drejtimit agresiv, udhëtimi me shpejtësi më të ulët, frenimi paraprak, fryrja e gomave në mënyrën e duhur, reduktimi i kohës së qëndrimit me motorin ndezur dhe shmangia e mbingarkesës, zvogëlojnë konsumin e lëndës djegëse dhe ulin shkarkimet e CO₂ nga autovecurat e tyre për pasagjer;

5. Një shpjegim mbi efektet e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, ndryshimet e mundshme klimatike dhe si ndikojnë autovecurat, si dhe një referencë mbi lëndët e ndryshme djegëse, që janë në dispozicion të konsumatorit dhe ndikimet e tyre në mjedis, bazuar në provat më të fundit shkencore dhe kërkesat ligjore.

Tabela me të dhënat që do përfshihen në udhërrëfyesin mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂.

Tipi dhe modeli i autovecurës	Lloji i lëndës djegëse	WLTP vlerat e konsumit zyrtar të lëndës djegëse (të kombinuara) (l/100 km ose m ³ /100 km ose kwh/100 km bazuar në llojin e lëndës djegëse)	Shkarkimet e CO ₂ (g/km)

SHTOJCA III AFISHIMI/POSTERI QË SHFAQET NË PIKËN E SHITJES

Për qëllime të këtij vendimi, afishimi/posteri të plotësojë të paktën kërkesat, si më poshtë vijon:

1. Afishimi ose posterit të ketë një madhësi minimale/të paktën prej 70 cm × 50 cm;
2. Informacioni të jetë lehtësisht i lexueshëm;
3. Kur informacioni jepet në një ekran elektronik, përmasat e ekranit të jenë të paktën 25 cm × 32 cm (17 inç). Informacioni mund të shfaqet duke përdorur teknikat e rrëshqitjes (*scroll*);

4. Modelet e autovecurave për pasagjer grupohen dhe renditen të ndara sipas llojit të lëndës djegëse që përdor (p.sh. benzinë ose naftë.). Për çdo lloj lënde djegëse/karburanti, modelet renditen në rend rritës për shkarkimet e CO₂ dhe modeli me konsumin më të ulët zyrtar të lëndës djegëse vendoset në krye të listës;

5. Për çdo model autovecure për pasagjer të listuar jepet marka, vlera numerike e konsumit zyrtar të lëndës djegëse dhe shkarkimet specifike zyrtare të CO₂. Vlera e konsumit zyrtar të lëndës djegëse shprehet në litra për 100 kilometra (l/100 km), kilometra për litër (km/l), ose një kombinim i përshtatshëm midis tyre dhe pasqyrohet deri në një numër pas presjes dhjetore. Shkarkimet specifike zyrtare të CO₂ shprehen të rrumbullakosura në numrin më të afërt të plotë në gram për kilometër (g/km);

6. Afishimi/posteri përmban tekstin e mëposhtëm, në lidhje me disponueshmërinë e udhërrëfyesit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂: “Një udhërrëfyes mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂, i cili përmban të dhëna për të gjitha modelet e autovecurave të reja, është i disponueshëm falas në çdo pikë shitje”. Në rastin e një afishimi/posteri elektronik, ky mesazh të jetë gjithmonë i paraqitur;

7. Afishimi/posteri përmban tekstin në vijim: “Përveç eficiencës së lëndës djegëse të një autovecure, mënyra e drejtimit të autovecurës, si dhe faktorë të tjerë joteknikë, luajnë rol në përcaktimin e konsumit të lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ të një autovecure. CO₂ është gazi

kryesor me efekt serrë, përgjegjës për ngrohjen globale”. Në rastin e një ekrani elektronik, ky mesazh të jetë gjithmonë i paraqitur;

8. Afishimi/posteri përditësohet të paktën çdo gjashtë muaj. Kur përdoret një ekran elektronik, informacioni përditësohet të paktën çdo tre muaj;

9. Afishimi/posteri mund të zëvendësohet plotësisht dhe përgjithmonë nga një ekran elektronik. Në këtë rast, ekrani elektronik do të paraqitet në mënyrë të tillë, që të tërheqë vëmendjen dhe të ndërgjegjësojë konsumatorin të paktën me të njëjtin intensitet, siç do të kishte arritur një afishim/poster.

Një format i posterit, jepet më poshtë:

Lloji i lëndës djegëse	Renditja	Modeli	Shkarkimet zyrtare specifike të CO ₂ (g/km)	Konsumi zyrtar i lëndës djegëse (l/100km ose m ³ /100km)
Benzinë	1.			
	2.			
	...			
Naftë	1.			
	2.			
	...			
Biodiesel	1.			
	2.			
	...			
Gaz i lëngshëm (LPG)	1.			
	2.			
	...			
Gaz natyror i kompresuar (CNG)	1.			
	2.			
	...			
Sistemet hibride	1.			
	2.			
	...			
...	1.			
	2.			
	...			

SHTOJCA IV

SIGURIMI I TË DHËNAVE MBI KONSUMIN E LËNDËS DJEGËSE DHE SHKARKIMET E CO₂ NË LËTERATURA PROMOVUESE

Të gjitha literaturat promovuese të përmbajnë konsumin zyrtar të lëndës djegëse dhe të dhënat zyrtare specifike të shkarkimeve të CO₂ për autoveturat, të cilave u referohen. Ky informacion të plotësojë të paktën kërkesat, si më poshtë vijon:

1. Të jetë lehtësisht i lexueshëm dhe jo më pak i rëndësishëm se pjesa kryesore e informacionit e dhënë në literaturën promovuese;

2. Të jetë lehtësisht i kuptueshëm edhe me një lexim të shpejtë;

3. Të dhënat e konsumit zyrtar të lëndës djegëse të sigurohen për të gjitha modelet e ndryshme të autoveturave që mbulon materiali promovues. Nëse specifikohet më shumë se një model, atëherë të përfshihen të dhënat zyrtare të konsumit të lëndës djegëse për të gjitha modelet e specifikuar, ose të përcaktohet diapazoni midis konsumit më të keq (më të lartë) dhe më të mirë (më të ulët) të lëndës djegëse. Konsumi i lëndës djegëse të shprehet në litra për 100 kilometra (l/100 km), kilometra për litër (km/l), ose një kombinim i përshtatshëm midis tyre. Të gjitha të dhënat numerike shprehen deri në një numër pas presjes dhjetore.

Nëse literatura promovuese përmban vetëm referencën e markës së autoveturës, e jo të ndonjë modeli në veçanti, atëherë të dhënat për konsumin e lëndës djegëse nuk është e nevojshme të jenë të pasqyruara.